# V E N D I M

## PËR

## NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.513, DATË 13.6.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE E TË DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6, pika 1, shkronja "e", dhe 22, pika 5, të ligjit nr.108/2013, "Për të huajt", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Në aneksin 4, "Lista e vendeve, shtetasit e të cilave hyjnë me vizë në Republikën e Shqipërisë dhe përfaqësitë ku mund të bëhet aplikimi, si dhe tarifa përkatëse e shërbimit me vizë", bashkëlidhur vendimit nr.513, datë 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, tarifa e pajisjes me vizë të tipit C me një hyrje, dy hyrje, shumë hyrje dhe për vizë të tipit D, për shtetasit e Kuvajtit, të bëhet 25 euro.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**